



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 3416/ 7 Prot.,

Datë 16.12.2024

**V E N D I M**  
**Nr. 1764 /2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.12.2024 shqyrtoi ankesën me

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “SARDO” ShPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur Mallra*”, me Nr. REF-24047-10-11-2024, me objekt: “Blerje Materiale Hidraulike”, me fond limit 15,687,185 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “SARDO” SHPK me Nipt. K13120402W.  
*Adresa: Lagjja “Apollonia”, Rr. “Jakov Mile”, Z. Kadastrale 8534, Nr. Pasurisë 3/5-N12, Fier.*

**Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Fier SH.A  
*Adresa: Lagjja. “1 Maji”, Rr. “Tasi Dema”, Fier.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 14.10.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-24047-10-11-2024, me objekt “Blerje Materiale Hidraulike”, me fond limit 15,687,185 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier, SH.A

II.2 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), rezulton se autoriteti kontraktor në datën 15.11.2024 ka përfunduar vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, në sistemin e prokurimeve elektronike (S.P.E.), dhe kryer renditjen e rezultateve të vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

1.”SARDO” SHPK	me vlerë të ofertës	13,400,000	Lek pa TVSH	Skualifikuar
2.“A.K.M ALBANIAN INVESTMENT GROUP” SHPK	me vlerë të ofertës	14,417,725	“	Kualifikuar
3. “ARDIT – 06” SHPK		13,400,000	“	Skualifikuar

II.3 Nga verifikimet e kryera në SPE Autoriteti kontraktor më date **18.11.2024** ka publikuar Njoftim fituesi, për procedurën e prokurimit objekt gjykimi.

II.4 Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2024/4814,

datë 20.11.2024 dhe me Nr. 3416/2024 Prot., datë 20.11.2024 e operatorit ekonomik “SARDO” ShPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me Nr. REF-24047-10-11-2024, me objekt: “Blerje Materiale Hidraulike”, me fond limit 15,687,185 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “SARDO” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.5 Bazuar në nenin 112 pika 4 germa “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe Formularin për publikim nr. 3416/2 prot., datë 21.11.2024 lidhur me pretendimet mbi vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.6. Nëpërmjet Shërbimit Postar operatori ekonomik “SARDO” ShPK ka përcjellë pranë KPP-së Formularin e ankesës, shtojca 21, protokolluar me tonën me nr. 3416/3, datë 25.11.2024.

II.7. Në përfundim të afatit 5 ditor, brenda të cilit autoriteti kontraktor ka detyrimin ligjor të trajtimit të ankesës dhe daljes me një vendim përfundimtar në lidhje me të, pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar shkresa nr. 2772/3 prot., datë 26.11.2024 protokolluar me tonën me nr. 3416/4, datë 02.12.2024 me objekt “*Informacion për Vendimin e marrë nga KSHA*”.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe me vendimin nr. 2772/2 prot., datë 26.11.2024 ka vendosur mospranim të ankesës.

II.8. Referuar nenit 113 të ligjit 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar, nuk janë paraqitur argumentet nga operatorët ekonomikë të interesuar për këtë procedurë prokurimi.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik,**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën e operatorit ekonomik “SARDO” SHPK, i cili kundërshton arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

#### **Arsyet e skualifikimit:**

*Operatori Ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik, pasi Nga verifikimi teknik i mostrave të paraqitura për të parë përputhshmërinë me specififikimet teknike të kërkuara nga AK, u konstatuan mospërputhje për zërat:*

• *FASHETA INOKSI QORRE* kishte përmasa FI 95-102 dhe jo FI 84-105, sipas specifikimeve të AK për artikullin me nr.rendor 5 në tabelë në DST.

*Pretendime të Ankimuesit:*

***Për sa i përket diametrin ne momentin e lëvrimin të mallit ne si operator jemi të detyruar të sjellim sipas madhësisë së kërkuar nga AK. Kjo arsye nuk qëndron, pasi mostra e dorëzuar nga ne përmbush specifikat e kërkuara nga AK.***

• *Zëri FASHETA INOKSI ME DALJE TE FLLANXHUAR (240-260) X (nr.rendor 6 në tabelë), në mostrën e paraqitur nga OE ka dalje të PAFLLANXHUAR. (OE përmes dokumentit DEKLARATË të ngarkuar në SPE, ka pranuar se për këtë mostër ka hasur vështirësi të gjendet sipas kërkesës së AK, pasi nuk gjendet në treg ashtu si është kërkuar dhe mundësohet vetëm me porosi që e cila do të garantohet nga OE kur të kërkohet lëvrimi i mallit në qoftë se shpallet fitues, për këtë mostër është zgjedhur një mostër e paflanaxhuar, por që tregon cilësinë dhe përmbush specifikimet teknike.)*

***Përsa i përket kësaj arsye ne si operator ekonomik kemi sjellë mostrën te paflanaxhuar për të treguar cilësinë e saj dhe kemi deklaruar në sistemin ekonomik që do të garantohet kur të bëhet lëvrimi i mall sipas kërkesave të AK. Mostra jonë është me standardet evropës të kërkuara nga AK dhe plotëson specifikat e kërkuara.***

• *Zëri TUBO PEHD FI 63 16 ATM, nga ana e OE është dorëzuar me presion 10 ATM.*

***Kjo arsye nuk qëndron, pasi mostra e dorëzuar nga ne përmbush specifikat e kërkuara nga AK.***

• *Për REDUKTOR PRESIONI DN 125, është dorëzuar me përmasa DN 80" (OE përmes dokumentit DEKLARATË të ngarkuar në SPE, ka pranuar se ka sjellë një mostër me përmasa më të vogla dhe me cilësinë që përmbush specifikimet teknike, përmasa e duhur do të garantohet nga ana jonë kur të kërkohet lëvrimi i mallit në qoftë se shpallet fitues, ky artikull është shumë i kushtueshëm dhe nuk mund të blihet sa për të treguar si mostër, por vetëm për t'u sjellë si material në fazën e lëvrimin të mallit.)*

***Përsa i përket kësaj arsye ne si operator ekonomik kemi sjellë mostrën REDUKTOR PRESIONI DN 80 për të treguar cilësinë e saj dhe kemi deklaruar ne sistemin ekonomik që do të garantohet kur të bëhet lëvrimi i mallit sipas kërkesave të AK. Mostra jonë është me standardet evropës të kërkuara nga AK Kjo arsye nuk qëndron.***

• *Në vend të BASHKUES I TEJDUKSHËM PP ME SITE DN32, është paraqitur FILTËR I TEJDUKSHËM.*

***Mostra e sjellë nga ne është kuptuar filtër uji, pasi dhe ai është i tejdukshëm me site dhe ka dalje dn32 nga të dy krahët. Nuk është qartësuar nga AK duke u ilustruar se çfarë është. Oferta jonë nuk quhet jo e rregullt për këtë arsye i cili është faj i AK që nuk e ka qartësuar se çfarë janë këto BASHKUES I TEJDUKSHËM PP ME SITE DN32 2cope sasi totale ne preventi.***

• *Për FASHETE EF PE100 DE 40 X 40 16 ATM, është dorëzuar FASHETË me përmasa 100x1" 10 ATM.*

Mosdorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave ose mospërputhja e mallrave të ofruara me mostrat e paraqitura, është kusht për skualifikim. Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr.Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

**Për mostrën nr.19 është sjellë një mostër me përmasa më të vogla dhe me cilësinë e që përmbush specifikimet teknike përmasa e duhur do të garantohet nga ana jonë kur të kërkohet lëvrimi i mallit në qofte se shpallemi fitues, ky artikull është shumë i kushtueshëm dhe nuk mund të blihet sa për të treguar si mostër por, vetëm për t'u sjellë si material në fazën e lëvrimit të mallit.**

**MOSTRA ka për qëllim që të njihet cilësia e mallit dhe gjatë lëvrimit të mallit ka komision marrje në dorëzim të mallit i cili merr në dorëzim mallin ashtu si është kërkuar në preventiv. Faza e dorëzimit të mostrave ka për qëllim të tregoj cilesinë e mallit dhe jo të skualifikojë ofertën tonë të favorshme për AK të bazuar në çmim sepse përmasat nuk janë si janë në preventiv. Ne kemi përmbushur të gjitha kriteret e kualifikimit dhe përmbushim cilësinë e duhur duke e vërtetuar me autorizimet e Distributorëve dhe katalogët të cilët tregojnë që cilësia e mallit përmbush specifikat e duhura.**

### III.1.1. Autoriteti Kontraktor ka publikuar në DST shtojcat 6, FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike për artikujt objekt skualifikimi të operatorit ekonomik ankimes si vijon:

- **Fasheta Inoksi Qorre**

Fashetat riparuese të jenë inoks (AISI 304 sipas standartit EN 1.4301) ose ekuivalent. Gomina të jetë e ngjitur me fashetën e inoksit me ngjithës të përforcuar me fibra xhami për të pasur jetëgjatësi dhe qëndrueshmëri ndaj temperaturave të larta dhe lagështisë gjatë montimit. Fashetat e inoksit të jenë të certifikuara nga institucione ndërkombëtare për përdorim në ujë të pijshëm dhe të jenë të pajisura me certifikata të tipit ACS, WRAS, BS ose ekuivalente. Pjesa e gomuar e fashetës të jetë gome EPDM,NBR ose ekuivalente të këtyre materialeve. Goma e përdorur në fashetën e inoksit duhet të jetë cilësi shumë e lartë sepse ka kontakt të drejtpërdrejt me ujin e pijshëm prandaj ajo duhet të jetë për përdorim për ujë të pijshëm.

- **Fasheta Inoksi me dalje të fllanxhuar**

Fashetat riparuese të jenë inoks (AISI 304 sipas standartit EN 1.4301) ose ekuivalent. Fashetat duhet të jenë me dalje me fllanxhe. Gomina të jetë e ngjitur me fashetën e inoksit me ngjithës të përforcuar me fibra xhami për të pasur jetëgjatësi dhe qëndrueshmëri ndaj temperaturave të larta dhe lagështisë gjatë montimit. Fashetat e inoksit të jenë të certifikuara nga institucione ndërkombëtare për përdorim në ujë të pijshëm dhe të jenë të pajisura me certifikata të tipit ACS, WRAS, BS ose ekuivalente. Pjesa e gomuar e fashetës të jetë gome EPDM,NBR ose ekuivalente të këtyre materialeve. Goma e përdorur në fashetën e inoksit duhet të jetë cilësi shumë e lartë sepse ka kontakt të drejtpërdrejt me ujin e pijshëm prandaj ajo duhet të jetë për përdorim për ujë të pijshëm.

- **TUBOT HDPE**

Tuba polietileni me dendësi të lartë. Të jenë sipas standartit EN 12201 ose ekuivalent me të. Tubat të kenë një koeficient sigurimi minimalisht 1.20. Materialet e përdorura për prodhimin e tubave të jenë jo toksike dhe të mosndikojnë në cilësinë e ujit (most'i japin atij as erë as shije). Të jenë fleksibël dhe me rezistencë ndaj vibrimeve dhe goditjeve sizmike, përt'upërshtatur me relievin e tokës. Të jenë rezistent ndaj rrezeve ultraviolet dhe ndaj temperaturave -25 derinë 55°C. Të kenë rezistencë të lartë ndaj gërryerjes dhe jetëgjatësi të paktën 50 vjet. Pamja e

*jashtme: të kenë sipërfaqe të lëmuar dhe pa dëmtime, prerja fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qendrën e tubit. Produktet duhet të kenë certifikatë aprovimi nga të paktën 1(një) institucion ndërkombëtar ose kombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh DVGW). Përmasat dhe presionet e punës së tubove përkatësisht sipas preventivit.*

• **BASHKUES I TEJDUKSHËM PP ME SITE DN32**

*Bashkuesi duhet të jetë material polipropilen me shtrëngim nga të dy krahet. Trupi i bashkuesit duhet të jetë i tejdukshëm në mënyre të dallohet uji kur kalon në të. Bashkuesi brenda trupit të tij duhet të ketë një sitë, për të përmirësuar cilësinë e ujit. Bashkuesi duhet të jetë i certifikuar për përdorim në ujë të pijshëm, si pasojë e kontaktit të drejtpërdrejt me të. Presioni i punës së këtyre bashkuesve të jetë minimumi 10 bar.*

**Shtojca 8, 2.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.4** Operatorët Ekonomikë në momentin e hapjes së ofertave, duhet të paraqesin nga **një mostër** për artikujt/zërat si më poshtë:

Nr	Përshkrimi materialit	Njësia
1	BRRYLA FI 20X3/4" Mashkull 16Atm	copë
2	MANIKOTA ME ELEKTROFUZION DN125 16Atm	copë
3	REKORDE HDPE 20X1/2" 16ATM Mashkull 16Atm	copë
4	REKORDE HDPE 25X3/4" 16ATM mashkull 16Atm	copë
5	FASHETA INOKSI QORRE FI 84-105	copë
6	FASHETA INOKSI ME DALJE TE FLLANXHUAR (240-260) X 100 L=300mm	copë
7	TAPA FUNDOR ME NGJITJE DN 250 16Atm	copë
9	TI HDPE DN 63X40X63 16Atm	copë
10	BASHKUES PP FI 110 16 ATM	ml
11	TUBO PEHD FI 25 10 ATM	ml
12	TUBO PEHD FI 40 10 ATM	ml
13	TUBO PEHD FI 63 10 ATM	copë
14	TUBO PEHD FI 20 16 ATM	copë
15	TUBO PEHD FI 32 16 ATM	copë
16	TUBO PEHD FI 50 16 ATM	copë
17	TUBO PEHD FI 63 16 ATM	copë
18	SARACINESKA 6" (PËR DEPOZITË)	copë
19	REDUKTOR PRESJONI DN 125	copë
20	BASHKUES I TEJDUKSHËM PP ME SITË DN32	copë
21	BASHKUES GIZE ME SISTEM SHTRËNGIMI ME KAPESE DN 198-228 16Atm	copë
22	FASHETË EF ME SHPIM NË PRANI TË UJIT 75*25 16 Atm	copë
23	FASHETË EF ME SHPIM NË PRANI TË UJIT 75*20 16 Atm	copë
24	FASHETË EF PE100 DE 40 X 32 16 ATM	copë
25	FASHETË EF PE100 DE 40 X 40 16 ATM	copë
26	FASHETË EF PE100 DE160X40 16 ATM	copë
27	FASHETË EF PE100 DE160X 50 16 ATM	copë
28	TEE HDPE ME NGJITJE DN 160 mm Atm 16	copë
29	TEE HDPE ME NGJITJE DN 40 mm Atm 16	copë
30	REDUKSION EF 16 Atm 32X20	copë

Dorëzimi i mostrave të bëhet pranë Drejtorisë Teknike, të Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizime Fier Sh.A, të mbyllura në një kuti jo transparente, të vulosur mbi të, cilin të shënohet: “Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit **“Blerje Materiale Hidraulike”**”.

**Data e dorëzimit të mostrave të jetë data e hapjes së ofertave data \_\_.\_\_.2024, deri në orën 10:00.** Mostrat e dorëzuara jashtë këtij afati, nuk do të pranohen nga AK.

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë nr.rendor të Artikullit që përfaqëson. Mosdorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave ose mospërputhja e mallrave të ofruara me mostrat e paraqitura, është kusht për skualifikim. Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuara sipas Nr. Rendor, nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

III.1.2. Neni 36, “Specifikimet teknike” të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose të ofrimit të punëve, të furnizimeve ose të shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose të projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar: a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën; b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve; c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

7. Autoriteti ose enti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike, referuar parashikimeve të mësipërme, kryen verifikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera kombëtare në rast se ekzistojnë standarde kombëtare ose ndërkombëtare në fuqi për mallrat, punët dhe shërbimet. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuar të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara në përputhje me parashikimet evropiane.

III.1.3 Referuar nenit 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.4. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 6 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, kërkohet shprehimisht:

“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet



*të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*

*b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*

*c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë të gjitha kriteret kualifikues në përputhje me kërkesat e AK si në përmbajtjen e tyre edhe në formën e rregullt të përcaktuar.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe të pranuar prej tyre.

Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë *d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

III.1.6. Komisioni gjykon referuar dokumentacionit të dosjes administrative dhe referuar kriteve të veçanta të kualifikimit ku rezulton, se është kërkuar shprehimisht në kriterin 2.3.4 që operatorët ekonomikë ofertues në momentin e hapjes së ofertave, duhet të paraqesin nga **një mostër** për artikujt/zërat si në tabelën bashkëlidhur kriterit.

Nisur nga arsyeja e skualifikimit si edhe dokumentacionit të AK përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik konstatoi, se ky i fundit në Proces-Verbalin mbi Vlerësimin dhe Verifikimin e Mostrave ka konstatuar parregullsi për mostrat që i korrespondojnë artikujve me Nr. 5, 6, 17, 19, 20 dhe 25. Dokumenti është i firmosuar nga KVO dhe nga përfaqësuesi i operatori ekonomik “SARDO” SHPK.

Akoma më tej operatori ekonomik ankimues pranon në ankesën e tij për mosplotësim të specifikimeve teknike për mostrat objekt skualifikimi.

Komisioni vëren se në një procedurë prokurimi qëllimi i AK për paraqitje të mostrave është që të krijojë siguri se ato janë në përputhshmëri me specifikimet teknike dhe kriteret për kualifikim, në përputhje me nenin 77 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato. Nëse operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime mbi specifikimet teknike për artikujt objekt prokurimi, ka pasur momentin procedural për të paraqitur ankesë për modifikim të DST-ve.

Përsa i përket pretendimeve mbi cilësinë e artikujve objekt skualifikimi, operatori ekonomik nuk ka argumentuar me fakte konkrete cilësinë e tyre apo edhe përcaktimin e qartë të artikujve në katalogët për të cilët pretendon se janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në DST.

Referuar dokumenteve të dosjes administrative, ankesës dhe argumenteve të operatorit ekonomik, Komisioni gjykon se operatori ekonomik nuk përmbush kriteret për kualifikim e konkretisht kriterin 2.3.4.

Përsa referuar pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “SARDO” SHPK për procedurën e prokurimit *Procedurë e Hapur Mallra*, me Nr. REF-24047-10-11-2024, me objekt: “Blerje Materiale Hidraulike”, me fond limit 15,687,185 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 30.10.2024 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Fier SH.A.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SARDO” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ, Tiranë.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Fiorent Zguro</b>	<b>Kreshnik Ternova</b>	<b>Gjergj Mersini</b>
	<b>Kryetar</b>	
	<b>Jonaid Myzyri</b>	

